

20080891671

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR PËRMENDORET
PËRKUJTIMORE DHE SHENJAT PËRKUJTIMORE

Neni 1

Në Ligjin për përmendoret përkujtimore dhe shenjat përkujtimore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 66/2004), titulli i Kreut VII "Dispozita ndëshkuese" zëvendësohet si vijon: "Dispozita për kundërvajtje".

Neni 2

Neni 28 ndryshon si vijon:

"Gjobë në shumë prej 4 000 deri më 5 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik nëse:

- ngre përmendore përkujtimore ose shenjë-përkujtimore që nuk janë të përmbajtura në Programin e nenit 6 ose në programet e nenit 18, të këtij ligji dhe

- nëse ngre përmendore përkujtimore ose shenjë-përkujtimore pa leje nga neni 25 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 1 000 deri më 1 500 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) alineja 1 dhe 2 të këtij neni, edhe personit përgjegjës në personin juridik.

Gjobë në shumë prej 800 deri më 1 000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) alineja 1 dhe 2 të këtij neni edhe personit fizik".

Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) të këtij neni, personit juridik mund t'i kumtohet masë e veçantë për kundërvajtje mënjanimin e përmendores përkujtimore përkatësisht shenjës-përkujtimore.

Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) të këtij neni, personit fizik mund t'i kumtohet masë e veçantë për kundërvajtje mënjanimin e përmendores përkujtimore përkatësisht shenjës-përkujtimore."

Neni 3

Neni 29 ndryshon si vijon:

"Gjobë në shumë prej 2 000 deri më 3 000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik nëse:

- ndërmerr veprime në përmendoren e ndërtuar përkujtimore ose në afërsi të drejtpërdrejtë të saj me të cilat mund të prishet integriteti i përmendores përkujtimore pa pëlqimin e autorit dhe të subjektit të cilit i është besuar mbrojtja e përmendores përkujtimore (neni 16 paragrafi 1);

- zhvendos përmendore përkujtimore pa pëlqimin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë (neni 16 paragrafi 2);

- bën ndryshime në shenjën-përkujtimore ose në afërsi të drejtpërdrejtë të saj me të cilat mund të prishet integriteti i përmendores përkujtimore ose zhvendos shenjë-përkujtimore pa pëlqimin e subjektit të cilit i është besuar dhënia e pëlqimit të këtillë (neni 19).

Gjobë në shumë prej 800 deri më 1 300 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni, edhe personit përgjegjës në personin juridik.

Gjobë në shumë prej 800 deri më 1 000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni edhe personit fizik."

Neni 4

Pas nenit 29 shtohen dy nëntituj të rinj dhe dy nene të reja 29-a dhe 29-b si vijojnë:

"Kompetenca e gjykatës

Neni 29-a

Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 28 dhe 29 të këtij ligji, procedurë për kundërvajtje mban gjykata kompetente.

Barazimi

Neni 29-b

Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 28 dhe 29 të këtij ligji, inspektorët e kulturës e kanë për detyrë që kryerësit të kundërvajtjes t'i propozojnë procedurë për barazim para se ta paraqesin kërkesën për procedurë për kundërvajtje.

Kur kryerësi i kundërvajtjes pajtohet për mbajtjen e procedurës për barazim, inspektori i kulturës përpilon procesverbal në të cilin shënohen elementet qenësore të kundërvajtjes, koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së kundërvajtjes, përshkrimi i veprimit të kundërvajtjes dhe personat e hasur në vendngjarje.

Në procesverbal përcaktohet mënyra me të cilën do të mënjanohen pasojat e kundërvajtjes, si dhe mënyra e tejkalimit të pasojave të kryerjes së kundërvajtjes.

Inspektori i kulturës në procedurën për barazim kryerësit të kundërvajtjes mund t'i japë urdhërpagesë.

Nëse kryerësi e pranon urdhërpagesën është i obliguar që të njëjtën ta nënshkruajë. Pranimi i urdhërpagesës për kryerësin e kundërvajtjes shënohet në procesverbal.

Kur si kryerës i kundërvajtjes paraqitet person juridik, procesverbalin dhe urdhërpagesën i nënshkruan personi zyrtar, përkatësisht personi përgjegjës që është gjendur në vendngjarje gjatë mbikëqyrjes inspektuese ose person tjetër zyrtar ose person përgjegjës i cili ka deklaruar se ka të drejtë ta nënshkruajë procesverbalin dhe ta pranojë urdhërpagesën.

Deklarata e paragrafit 6 të këtij neni shënohet në procesverbal.

Inspektorët e kulturës janë të obliguar të mbajnë evidencë për procedurat e ngritura për barazim dhe për përfundimin e tyre.”

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.